REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:225977
Datë: 25.11.2021
Numri i dokumentit: 02440752

C.nr.1003/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari **Betim Behluli**, në çështjen juridike të paditësit M. A. I. nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, kundër të paditurve I. G. dhe L. G. të dy nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, vlera e kontestit 1,000.oo €uro, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit kryesor dhe zbatimit të provave, më **17.11.2021,** merr këtë:

A K T GJ Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit M. A. I., **SI E BAZUAR**.

VËRTETOHET se paditësi M. A. I. është pronar i pjesëve të parcelës kadastrale nr. 2111-0 dhe nr. 2157-0 ku pas copëtimit kanë marrë numrat e ri: nr. **2111-2** në sipërfaqe të përgjithshme prej **976 m²**, e cila parcelë kufizohet në veri-lindje me parcelën nr.2113-2 në gjatësi prej 25.94m. dhe me parcelën nr.2113-1 në gjatësi prej 2.23m. e në gjatësi të përgjithshme prej 28.17 m, në jug-lindje me parcelën nr.2114-0 në gjatësi prej 30.98m, në jug-perëndim me parcelën nr.2159-0 në gjatësi prej 30.76m. + 1.00m. = 31.76m, në veri-perëndim me parcelën amë nr.2111-0 në gjatësi prej 34.82m, dhe: parcela nr.**2157-2** kufizohet, në veri-lindje me parcelën nr.2159-0 në gjatësi prej 27.69 m, në jug-lindje me parcelën nr.2145-0 në gjatësi prej 24.92 m, në jug-perëndim me parcelën nr.2149-0 në gjatësi prej 13.98 m. me parcelën nr.2150-0 në gjatësi prej 13.28 m. dhe me parcelën nr.2151-0 në gjatësi prej 0.96m. e në gjatësi të përgjithshme prej 28.22 m, në veri-perëndim me parcelën amë nr.2157-0 në gjatësi prej 14.46 m, në bazë të parashkrimit fitues, çka të **paditurit** I. G. dhe L. G. janë të **obliguar** që të pranojnë këtë të drejtë dhe të lejojnë që paditësi të regjistrohet si pronarë në regjistrin Kadastral të Pronave pranë Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në Rahovec, ku si bazë juridike do të shërbejë ky aktgjykim dhe atë në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimit të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi A. Z. ka ushtruar padi kundër të paditurve, I. G. dhe L. G., për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të parashkrimit fitues.

2021:225978

Sipas kësaj çështje juridike gjykata ka caktuar disa seanca e shqyrtimin kryesor, në të cilat janë paraqitur paditësi M. I. personalisht si dhe të padituri I. G. dhe L. G. personalisht.

Paditësi M. I. ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke theksuar se ai nga të padituri i ka blerë pjesët e parcelave që janë objekt i këtij kontesti për të cilën që nga ajo kohë çmimi i kontraktuar është kryer në momentin e shitblerjes dhe ai është shfrytëzues dhe posedues i parcelës që nga ajo kohë pa u penguar nga askush, fakt të cilin edhe të padituri e kanë pohuar, i propozoi gjykatës që të dalë në vend dhe pretendimet e t'ia ti vërtetoj dhe së bashku me ekspertin gjeometër të bëj identifikimin e pjesëve të parcelave parcelave. Në seancën e shqyrtimit kryesor paditësi bëri precizimin e objektit të kërkesëpadisë ashtu që i propozoi gjykatës që ta aprovojë padinë dhe kërkesëpadinë dhe të vërtetojë se paditësi është pronar i parcelave të reja të krijuara dhe atë parcela nr. 2111-2 në sipërfaqe prej 972m2, dhe parcela nr. 2157-2 në sipërfaqe prej 532m2. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me daljen e gjykatës në vend, me ekspertizën e ekspertit gjeometër, e në veçanti nga deklarimi i palëve ndërgjyqëse, e kanë pranuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e tij, ashtu që gjykata tani më pa mëdyshje mund të vërtetoi këtë gjendje faktike dhe padinë dhe kërkesëpadinë e tij ta aprovojë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet procedurale i bartë ai.

I padituri i parë I. G. dhe i padituri i dytë L. G. një zëri deklaruan se nuk e kontestojnë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, është fakt i pa kontestueshëm se paditësi M. I. i ka blerë pjesët e parcelave kontestuese që nga viti 1993, të njëjtat është duke i shfrytëzuar pa u penguar nga askush që nga koha e shitblerjes e deri më sot dhe e ka të ndërtuar shtëpinë e tij ku është duke jetuar, këto fakte mund të i vërtetojnë edhe në vend. Gjithashtu në seancën e shqyrtimit kryesor dhe ne fjalën përfundimtare të padituri njëzëri deklaruan se gjykata nga dalja në vend në mënyrë të pa kontestueshëm e vërtetoi gjendjen faktike se paditësi M. I. është në shfrytëzim dhe posedim të pjesëve të parcelave- të parcelave të krijuara kontestuese dhe ka fituar të drejtën e pronësisë, e cila gjendje faktike korrespondon me deklarime e tyre, dhe krejt në fund i propozuan gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Për të vërtetuar faktet vendimtare, gjykata i ka zbatuar këto prova: ka bërë shikimin në certifikatën e pronësisë të datës 18.02.2021, për parcelën nr. 2755-0 dhe nr. 4750-0 ZK Krushë e Madhe, ka bërë shikim në dëshmi vdekjen për të ndjerin A. B. G. e datës 04.02.2021 prej së cilës vërtetohet se të padituri janë trashëgimtar të të ndjerit, ka bëri shikimin në deklaratat e të padituri vë dhëna pranë Noteres S. S., si dhe ka bërë shikimin në ekspertizës dhe skicës së terrenit të ekspertit gjeometër të G.-L. prej datës 09.11.2021.

Pas analizimit dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç, duke i vlerësuar në deklaratat e ndërgjyqësve si dhe duke u mbështetur në dispozitën e nenit 7 dhe 8 të LPK-së, në bazë të bindjes së vetë të lirë, është konstatuar se kërkesë padia e paditësit është **e bazuar dhe e njëjta është aprovuar**.

Nga provat të zbatuara është vërtetuar kjo gjendje faktike:

Me shikimin në certifikatën e pronësisë të datës 18.02.2021 ZK Krushë e Madhe, vërtetohet se parcela kadastrale nr. 2755-0 dhe nr. 4750-0, ZK Krushë e Madhe, evidentohet në emër të të ndjerit A. G., i ati i të padituri vë.

Me shikimin në dëshmi vdekjen për të ndjerin A. B. G. e datës 04.02.2021 prej së cilës vërtetohet se të padituri janë trashëgimtar të të ndjerit.

Me shikimin në deklaratat e të paditurve të dhëna pranë Noteres S. S., vërtetohet se i ati i të paditurve ia ka shitur blerësit tani të ndjerë A. I., të atit të paditësit M. I..

Me shikimin në ekspertizën dhe skicës së terrenit të kompanisë G.-L. të datës 09.11.2021, është konstatuar se: parcela kontestuese nr. 2755-0 dhe nr. 4750-0, ZK Krushë e Madhe, evidentohet në emër të të ndjerit A. G., dhe pas identifikimit dhe matjeve të parcelave kontestuese eksperti gjeometër bëri matjen e pjesëve të parcelave kontestuese sipas shfrytëzimit dhe i njëjti në ekspertizë i ka paraqitur dimensionet e pjesëve të parcelave kontestuese dhe janë formuar numrat e rinj të parcelave si në ekspertizë.

Si fakte relevantë në këtë çështje juridike, gjykata murr për bazë se është argumentuar fakti se paditësi është në posedim të ligjshëm dhe mirëbesim dhe të paditurit i kanë pranuar të hollat, dhe se të paditurit nuk e kanë kundërshtuar që paluajtshmëria të bartet në emër të paditësit.

Ligji për Pronësi dhe të Drejta tjera Sendore me dispozitën e nenit 40. 1 parasheh se: ***Personi i cili me mirëbesim e ka njëzetë (20) vjet në posedim të pandërprerë një paluajtshmëri ose një pjesë të saj, e fiton pronësinë në të***, sipas kësaj gjendje të vërtetuar gjykata vlerëson se paditësi në shfrytëzim të pronës është vendosur posedim të ligjshëm dhe mirëbesim rreth mbi 20 vite, i cili kusht është plotësuar edhe me LTHMPJ-së, sipas dispozitës së nenit 28. 4.

Në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë e duke u mbështetur në dispozitën e nenit 28. 4 të LTHMPJ-së, dhe nenit 40. 1 të Ligjit për Pronësi dhe të Drejta tjera Sendore, si dhe neneve 143 dhe 254 dhe 319 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 450 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,
C.nr.1003/2021, më 17.11.2021

Gjyqtari
Betim Behluli

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet nëpërmjet të kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit, Divizioni Civil në Prishtinë.